



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Prilazim Nr. datë 01-07-2025			
Nr. Llogarit Gj. Breg	Numri dhe Titulli	Shtypje e Udhëzimit	Vlera Udhëzimit
01-	470/02		201



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2025, miraton këtë:

VENDIM

për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026.
Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

- | | |
|--------------------------|----------------------------------|
| 1. z.Bekim Azizi | Kryesues i Kuvendit Komunal |
| 2. znj.Zejnepe Osmani | Përfaqësues i GP i LDK-së; |
| 3. znj.Lindita Demelezi | Përfaqësues i GP i VV-së; |
| 4. znj. Anisë Zejnullahu | Përfaqësues i GP i PDK-së; |
| 5. z. Reshat Azizi | Këshilltar Komunal nga AAK-ja; |
| 6. z.Fatlum Demiri | Sekretaria e kuvendit; |
| 7. z. Shyqeri Halabaku | Përfaqësues nga shoqëria civile. |

Neni 2

Grupi punues, konform neni 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2026, dhe të njëjtin e paraqet para kuvendit të komunës për miratim.

Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbaj objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të kuvendit dhe komiteteve obligative dhe funksionale të kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara.

Neni 4

Plani i punës së kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konformë neni 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të grupit punues; dhe
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi